



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZLAnr.122/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi - kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa ZL.Anr.122/2025 datë 06.10.2025, parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), parashtruar kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 06.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë në të cilën ankesë thuhet se më datë 06.10.2025 aktivistët e Qendrës së Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, kanë identifikuar banerët/posterët të vendosura në hapësirat publike, përkatësisht në rrugën publike “Jonuz Koprani” në Prishtinë.

Ky veprim përbën shkelje të dispozitave ligjore për fushatën zgjedhore, konkretisht të nenit 34, paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Si prove në ankesë kanë bashkangjitur fotografi që dëshmon vendosjen e banerëve/posterëve në kundërshtim me LZP.

Në përgjigjen në ankesë të datës 07.10.2025, të Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) theksojnë se e kundërshtojnë ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), si të pabazuar.

Kanë theksuar se hapësirat ku janë vendosur materialet zgjedhore nuk janë shfrytëzuar në mënyrë të paligjshme, por kanë vepruar në mënyrë të rregullt, duke respektuar plotësisht legjislacionin në fuqi. Tutje, në përgjigje në ankesë theksohet se LDK, konkretisht, kandidatja Vjosa Rrahmani ka marrë pëlqim zyrtar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike me numër reference 07.353/02-143167/25, të datës 22.09.2025, në bazë të kërkesës së paraqitur. Me këtë pëlqim është lejuar vendosja e posterëve në rrugën “Tirana” dhe në Keqekollë – Ballaban përballë Xhamisë që korrespondon me rrugën që ka bërë ankuesi.

Tutje, kanë shtuar se vendosja e materialeve zgjedhore është bërë në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse, dhe si e tillë nuk përbën shkelje të nenit 34 të Ligjit për Zgjedhjet nga ana e subjekti politik LDK, duke propozuar që të refuzohet ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje si e pabazuar.

Si provë në përgjigje në ankesë e kanë bashkëngjitur pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike e Komunës së Prishtinës, me numër reference 07.353/02-143167/25 datë 22.09.2025.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se :

- Ankesa është e pa bazuar.

- Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, të subjektit politik LVV dhe përgjigjes në ankesë të parashtruar nga Subjekti Politik LDK, vlerësoj se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 par. 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe vendosja e emrave të tyre ose sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose ndryshe që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronareve ose shfrytëzuesve.”*

Paneli ka gjetur se në bazë të shkresave të bashkëngjitura në përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK kanë vërtetuar faktin se me datë 22.09.2025, kandidatja Vjosa Rrahmani ka marrë pëlqimin nr. 07.353/02-143167/25 datë 22.09.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Shërbime Publike të Komunës së Prishtinës - DSHKP për shfrytëzimin e hapësirës publike vendosjen e 3 Banerave që ekspozojnë foto të kandidatëve për Zgjedhje Lokale 2025 në objekt kolektiv në Rr.“Tirana”, dhe një në udhëkryqin e fshatit Keqekollë-Ballaban përballë Xhamisë. Pra vendosja e posterave është në pajtim me nenin 5 të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, Të drejtat dhe obligimet e subjekteve politike gjatë mbajtjes së tubimeve publike konkretisht në nenin 5 nën paragrafi 1.2, në të cilin nen ndër të

tjera thuhet se “të publikojnë dhe të shpërndajnë afishe përmes shtandëve apo ne hapësira publike, reklama dhe material tjetër lidhur me një fushatë zgjedhore”.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.122/2025 më datë 08.10.2025



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.